



DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR)

Në zbatim të V.K.M-së Nr. 40 datë 23.01.2019 dhe VKM-së Nr. 251 datë 27.03.2020 për përjashtimin nga tarifa e shkollimit, njoftojmë se aplikimi për të përfituar përjashtimin nga tarifa do të bëhet nga studenti nëpërmjet dorëzimit të dokumentave pranë Departamentit të gjuhës që studiojnë.

Studentët që regjistrohen në vitin e parë dhe të viteve të tjera mund t'a dorëzojnë dokumentacionin nga data **14.10.2024 deri në 01.11.2024**

Dokumentat që duhet të dorëzojnë studentët sipas kategorive janë si më poshtë:

a) **STUDENTET, FAMILJET E TË CILËVE TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Çertifikatë familjare.
3. **Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtim me ndihmë ekonomike** nga seksioni i ndihmës ekonomike në Bashki, ku të cilësohet nr. i dosjes dhe vlera e saj. Ky dokument duhet të shkarkohet nga portal e-albania dhe nuk do të pranohet nëse nuk është shkarkuar nga ky portal(e-albania)
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
5. Vërtetim student.

b) **BASHKËSHORTËT QË KANË FËMIJË DHE JANË TË DY STUDENTË:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Vërtetim studentit nga institucionet publike IAL për të dy prindërit.
3. Çertifikatë familjare.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

c) **STUDENTËT, PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA, TË VËRTETUAR NGA KOMISIONI MJEKËSOR I CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË, PËRFITUES TË PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR:**



Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
3. Raportin Mjeko Ligjor nga KMCAP-i (i fotokopjuar dhe i noterizuar).
4. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore apo nga zyrat e ndihmes ekonomike në Bashki për pagesën e aftësisë së kufizuar.
5. Vërtetim studentit.

ç) **STUDENTËT QË KANË TË PAKTËN NJËRIN PRIND PERSON ME AFTËSI TË KUFIZUARA, TË VËRTETUAR ME VENDIM TË KOMISIONIT MJEKËSOR TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË, PËRFITUES TË PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCAP-së (Komsionit të caktimit të aftësisë për punë) për të dy prindërit me aftësi të kufizuar (invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik).
3. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit
4. Vërtetim origjinal nga Njesia administrative për pagesën e paaftësisë për punë.
5. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës/ invalidin paraplegjik ose tetraplegjik;
6. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
7. Vërtetim studentit.

d) **STUDENTËT QË I KANË TË DY PRINDËRIT PENSIONISTË OSE NJËRIN PRIND PENSIONIST DHE PRINDI TJETËR NUK JETON:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të pleqërisë për prindin/ të dy prindërit.
3. Çertifikatë Familjare.
4. Çertifikatë të ndarjes së prindit nga jeta (në rastin kur njëri nga prindërit nuk jeton)
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
6. Vërtetim studentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



dh) STUDENTËT, TË TRETËT NË RADHËN E FËMIJËVE E LART, TË CILËT VIJNË NGA FAMILJE ME TRE FËMIJË E MË SHUMË, NGA TË CILËT DY TË PARËT JANË STUDENTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË:

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Çertifikatë Familjare.
3. Vërtetim për të dy fëmijët e parë që janë student në IAL Publike.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

e) STUDENTËT QË KANË PËRFITUAR STATUSIN E JETIMIT, DERI NË MOSHËN 25 VJEC.

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Çertifikatë Familjare.
3. Fotokopje të noterizuar të statusit të jetimit.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
5. Vërtetim studenti.

ë) STUDENTËT QË KANË HUMBUR KUJDESTARINË PRINDËRORE ME VENDIM GJYKATE TË FORMËS SË PRERË, DERI NË MOSHËN 25 VJEC:

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al).
2. Çertifikatë Familjare.
3. Vendimin e gjykatës të formës së prerë për humbjen e kujdestarisë prindërore..
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
5. Vërtetim studenti.

f) STUDENTËT QË JANË IDENTIFIKUAR SI VIKTIMA TË TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE DHE KANË PËRFITUAR STATUSIN LIGJOR PËR TRAJTIM SI VIKTIMA TË TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE, DERI NË MOSHËN 25 VJEC;

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Vërtetimin nga Ministria e Brendshme.
3. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
4. Vërtetim studenti.

g) STUDENTËT QË JANË FËMIJË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT, TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT DHE TË POLICISË SË BURGJEVE QË KANË HUMBUR JETËN NË KRYE DHE PËR SHKAK TË DETYRËS.

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Vërtetimin nga Ministria përkatëse.
3. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
4. Çertifikatë Familjare.
5. Vërtetim student.

h) STUDENTËT ROMË DHE EGJIPTIANË, TË CILËT DO TË IDENTIFIKOHEN NËPËRMJET VETËDEKLARIMIT:

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Formular vetedeklarimi te noterizuar.
3. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
4. Vërtetim studenti.

i) STUDENTËT FËMIJË TË ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST OSE FËMIJË ME PRINDËR TË DËNUAR POLITIKË ME HEQJE LIRIE;

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifa shkollimit. (shkarkohet nga faqja e fakultetit www.fgjh.edu.al)
2. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



-
3. Vërtetimi i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
 4. Vërtetim studenti.

SHËNIM:

NUK PËRFITOJNË NGA KY VENDIM INDIVIDËT QË U TAKOJNË SHITESAVE SOCIALE MË LART, TË CILËT:

- 1- Janë duke ndjekur një program të dytë studimi për të cilin duhet të përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.
- 2- Studentët përsëritës.

AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT NGA DATA 14.10.2024 DERI NË DATË 01.11.2024.

PAS DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE VERIFIKIMIT NË ZYRAT QË KANË LËSHUAR DOKUMENTIN, VENDIMI PËR STUDENTËT QË DO TË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT DO TË MERRET NGA BORDI I ADMINISTRIMIT.

PËR ÇDO PAQARTËSI DREJTOHUNI NË ADRESËN E MAIL-IT: info.fgjh@unitir.edu.al